



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2019:141779
Datë: 22.08.2024
Numri i dokumentit: 06074353

C.nr.429/18

Gjykata Themelore Gjakovë-Dega Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Nehat Qelaj në çështjen juridike të paditësit J.M.nga fshati G., Komuna e Malishevës, të cilin e përfaqëson avokati Xhevdet Krasniqi nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve „S.” me seli në Prishtinë, për Kompensimin e dëmit, jashtë shqyrtimit kryesor me datë 22.08.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

Konstatohet se është Tërhequr padia e paditësit J.M.nga fshati G., Komuna e Malishevës, e ushtruar me datë 19.02.2018 kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve „S.” me seli në Prishtinë, për Kompensimin e dëmit.

A r s y e t i m

Paditësi i lartpërmendur me datë 19.02.2018 në këtë gjykatë përmes të autorizuarit të tij Xhevdet Krasniqi nga Prishtina, ka parashtruar padinë ndaj të paditurës si më lartë për kompensimin e dëmit.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë, me datë 14.11.2019 e njoftoj të paditurën me aktvendim për përgjigje në padi. Pas pranimit të këtij aktvendimi e paditura në përgjigje në padi ndër tjera ka deklaruar se e konteston kërkesëpadinë e paditësit për kompensim dëmi material dhe jo material dhe se në procedurën e rregullore të paditura ka trajtuar kërkesën për kompensim dëmi material dhe jo material dhe në bazë të provave të paraqitura është konstatuar se kemi të bëjmë me lëndime të lehta trupore tek paditësi dhe sa i përket dëmit material tek vetura në bazë të provave komisioni për trajtimin e dëmeve materiale e ka vlerësuar dëmin dhe palës i është ofruar oferta për kompensimin e dëmit të veturës, e për më shume si në këtë përgjigje .

I autorizuari i paditësit av. Xhevdet Krasniqi, me datë 27.06.2024, në gjykatë deponon parashtrësën mbi tërheqjen e padisë protokolluar me datë 03.07.2024, me arsyetimin se paditësi me të paditurën kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore dhe nuk ka interes juridik të vazhduar këtë procedure gjyqësore.

Meqenëse e paditura ka paraqitur përgjigje në padi, gjykata një kopje të parashtrësës për tërheqjen e padisë ja ka dërguar të paditurës me qëllim të deklarimit për tërheqjen e padisë. E paditura nuk është deklaruar brenda afatit 7 ditësh nga dita e pranimit të njoftimit me datë

09.08.2024 , andaj meqenëse e paditura në afatin e lart cituar nuk është deklaruar për tërheqjen e padisë, në kuptim të nenin 261.2 të LPK-së konsiderohet se e njëjta e ka dhënë pëlqimin.

Bazuar nga të lartcekurat Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi konform nenit 261 të Ligjit Procedurës Kontestimore.

**Gjykata Themelore Gjakovë-Dega Malishevë,
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.429/18 datë 22.08.2024**

G j y q t a r i
Nehat Qelaj

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij Aktvendimi nuk lejohet parashtrimi i ankesës.